



KOMBET E BASHKUARA

Adresa: UNITED NATIONS, N.Y 10017

Adresa kabllore- UNATIONS NEWYORK

Lënda: C.N.872.2016. TREATIES- XXVII.2.F (Njoftim i Depozitarit)

PROTOKOLLI I MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË
SHTRESËN E OZONIT I DATËS 16 SHTATOR 1987AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT TE MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN
E OZONIT, KIGALI, 15 TETOR 2016

MIRATIMI I AMENDAMENTIT

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, në cilësinë e Depozitarit, komunikon si vijon:

Palët në Takimin e Njëzet e Tetë të Protokollit të lartpërmendur, i mbajtur në Kigali nga datat 10 deri më 15 tetor 2016, kanë miratuar në pajtim me procedurën e parashikuar në paragrafin 4 të nenit 9 të Konventës së Vjenës për Mbrotjtjen e Shtesës së Ozonit, një Amendament shtesë të Protokollit të Montrealit, siç është parashikuar në Aneksin I të raportit të Takimit të njëzet e tetë të Palëve (Vendim XXVIII/1).

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit IV, Amendamenti do të hyjë në fuqi më 1 janar 2019, me kusht që të jenë depozituar nga ana e Shteteve ose nga Organizatat Rajonale të Integritimit Ekonomik Palë të Protokollit të Montrealit për Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit, të paktën njëzet e tetë instrumente ratifikimi, aderimi apo miratimi të Amendamentit. Në rast se deri në atë datë ky kusht nuk është plotësuar, Amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë, pas datës në të cilën ky kusht është përmbushur.

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit IV, në vijim të hyrjes në fuqi të Amendamentit, ai do të hyjë në fuqi për çdo Palë tjetër të Protokollit në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të aderimit ose miratimit.

Vëmendje: Drejtuar Shërbimeve të Marrëveshjeve dhe Traktateve të Ministrive të Punëve të Jashtme, si dhe Organizatave Ndërkombëtare të interesuara.

Njoftimet depozituese lëshohen vetëm në format elektronik. Njoftimet depozituese janë në dispozicion të Misioneve të Përhershme të Kombeve të Bashkuara në adresën: <https://treaties.un.org>, seksioni i përmbledhjes së Traktateve të Kombeve të Bashkuara " Njoftimet Depozituese ". Përveç kësaj, Misionet e Përhershme si dhe çdo individ i interesuar, mund të abonohet në seksionin e Traktateve " Shërbimet automatike të abonimit" për të marrë njoftimet depozituese me email ose në adresën <https://treaties.un.org/Pages/Login.aspx?lang=en>.

C.N.872.2016.TRAKTATE-XXVII.2.f

ANEKSE

VENDIM: XXVIII/1: Amendament i Mëtejshëm i Protokollit të Montrealit

Për Miratimin e Amendamentit të Protokollit të Montrealit i përcaktuar në Shtojcën I të raportit të Takimit të Njëzet e Tetë të Palëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 9 të Konventës së Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit

Amendament i Protokollit të Montrealit për Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit

Neni I: Amendamenti

Neni 1, paragrafi 4

Në paragrafin 4 të nenit 1 të Protokollit, fjalët:

“Aneksi C ose Aneksi E”

ndryshohen si më poshtë:

“Aneksi C, Aneksi E ose Aneksi F”

Neni 2, paragrafi 5

Në paragrafin 5 të nenit 2 të Protokollit, fjalët:

“dhe nenin 2H”

ndryshohen si më poshtë:

“Nenin 2H dhe 2J”

Neni 2, paragrafët 8 (a), 9 (a), dhe 11

Në paragrafin 8(a) dhe 11 të Nenit 2 të Protokollit, fjalët:

“Neneve 2A deri në 2I”

Ndryshohen si më poshtë:

“Neneve 2A deri në 2J”

Fjalët e mëposhtme do të shtohen në fund të nënparagrafit (a) të paragrafit 8 të nenit 2 të Protokollit:

Çdo marrëveshje e tillë mund të shtrihet, duke përfshirë detyrimet në lidhje me konsumin ose prodhimin sipas nenit 2 J, me kusht që niveli total i kombinuar i konsumit ose prodhimit të palëve të interesuara të mos kalojë nivelet e kërkuara nga neni 2j

Në nënparagrafin (a) (i) të paragrafit 9 të nenit 2 të Protokollit, pas përdorimit të dytë të fjalëve:

duhet të bëhen,

fshihet fjala :

“dhe”

Nënparagrafi (a) (ii) i paragrafit 9 të nenit 2 të Protokollit rinumërohet si nënparagrafi (a) (iii).

Përmbajtja e mëposhtme shtohet si nënparagraf (a) (ii) pas nënparagrafit (a) (i) të paragrafit 9 të nenit 2 të Protokollit:

“Duhet të bëhen përshtatje/rregullime të potencialeve të ngrohjes globale të specifikuar në Grupin I të Aneksit A, Aneksit C dhe Aneksit F dhe nëse po, cilat rregullime duhen bërë dhe”

Neni 2J

Neni i mëposhtëm shtohet pas nenit 2I të Protokollit, “Neni 2J: Hidrofluorkarbone”

1. Çdo palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas Aneksit F i shprehur në ekuivalentet e CO₂, të mos kalojë përqindjen, e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuar në nënparagrafët e mëposhtëm nga (a) në (e), të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në Aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus pesëmbëdhjetë përqind të nivelit të llogaritur të konsumit të Aneksit C, Grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO₂:

- a) 2019 deri në 2023: 90 përqind
- b) 2024 deri në 2028: 60 përqind
- c) 2029 deri në 2033: 30 përqind
- d) 2034 deri në 2035: 20 përqind
- e) 2036 në vazhdim: 15 përqind

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vendosin që një palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas Aneksit F i shprehur në ekuivalentet e CO₂, të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuar në nënparagrafët e mëposhtëm nga (a) në (e) të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në Aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013, plus njëzet e pesë përqind të nivelit të llogaritur të konsumit të Aneksit C, Grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO₂ :

- a) 2020 deri në 2024: 95 përqind
- b) 2025 deri në 2028: 65 përqind

- c) 2029 deri në 2033: 30 për qind
 - d) 2034 deri në 2025: 20 për qind
 - e) 2036 në vazhdim: 15 për qind
3. Çdo palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas Aneksit F i shprehur në ekuivalentët e CO₂, të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nënparagrafët e mëposhtëm nga (a) në (e) të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në Aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus pesëmbëdhjetë përqind të nivelit të llogaritur të konsumit të Aneksit C, Grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO₂
- a) 2019 deri në 2023: 90 përqind
 - b) 2024 deri në 2028: 60 përqind
 - c) 2029 deri në 2033: 30 përqind
 - d) 2034 deri në 2035: 20 përqind
 - e) 2036 në vazhdim: 15 përqind
4. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vendosin që një palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas Aneksit F i shprehur në ekuivalentët e CO₂ të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nënparagrafët e mëposhtëm nga (a) në (e) të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në Aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus njëzet e pesë përqind të nivelit të llogaritur të konsumit të Aneksit C, Grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO₂ :
- a) 2020 deri në 2024: 95 përqind
 - b) 2025 deri në 2028: 65 përqind
 - c) 2029 deri në 2033: 30 përqind
 - d) 2034 deri në 2035: 20 përqind
 - e) 2036 në vazhdim: 15 përqind
5. Paragrafët nga 1 në 4 të këtij neni zbatohen deri në masën që Palët vendosin të lejojnë që niveli i prodhimit ose konsumit i nevojshëm për të përmbushur tipologjinë e përdorimit të rënë dakord nga palët për të qenë Palë të përjashtuara.
6. Çdo Palë që prodhon substanca të Aneksit C, Grupit I ose Aneksit F duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga data 1 janar 2020 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, emetimet e substancave të Aneksit F, Grupit II të gjeneruara në çdo objekt që prodhon substanca të Aneksit

C, Grupit I ose Aneksit F, substancat shkatërrohen në të njëjtën periudhë dymbëdhjetë mujore, në masën e mundësuar nga përdorimi i teknologjisë, të miratuar nga Palët

7. Çdo Palë duhet të sigurojë që çdo shkatërrim i substancave të Aneksit F, Grupit II, ose Aneksit F të gjeneruara nga objektet që prodhojnë substanca të Aneksit C, Grupit I ose Aneksit F, duhet të realizohet vetëm me teknologjitë e miratuara nga Palët.

Neni 3

Hyrja e Nenit 3 të Protokollit do të zëvendësohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Për qëllimet e nenit 2, 2A në 2J dhe 5, çdo Palë duhet që për çdo grup substancash të Aneksit A, Aneksit B, Aneksit C, Aneksit E ose Aneksit F, të përcaktojë nivelet e saj të llogaritura.”

Për pikëpresjen e fundit të nënparagrafëve (a) (i) të Aneksit 3 të Protokollit do të zëvendësohet si më poshtë:

“. Përrjashtimisht, siç është parashikuar në paragrafin 2;”

Teksti i mëposhtëm shtohet në fund të nenit 3 të Protokollit:

“ dhe

(d) Emetimet e substancave të Aneksit F, Grupit II, të gjeneruara në çdo objekt që prodhon substanca të Aneksit C, Grupit I ose Aneksit F, duke përfshirë ndër të tjera, sasitë e emetuar nga rrjedhjet e makinerive, proceseve të ventilimit dhe pajisjeve shkatërruese, por duke përjashtuar sasitë e kapura për përdorim, shkatërrim apo magazinim.

2. Për llogaritjen e niveleve të shprehura në ekuivalentë CO₂ të prodhimit, konsumit, importit, eksportit dhe emetimet e substancave të Aneksit F dhe Aneksit C, Grupit I, për qëllimet e nenit 2J, paragrafi 5 i nenit 2 dhe paragrafit 1 (d) të nenit 3, çdo Palë duhet të përdorë potencialet e ngrohjes globale për substancat e specifikuar në Grupin I të Aneksit A, Aneksit C dhe Aneksit F.”

Neni 4, paragrafi 1 sept

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 1 sex të nenit 4 të Protokollit:

“1 sept. Me hyrjen në fuqi të këtij paragrafi, çdo Palë duhet të ndalojë importimin e substancave të kontrolluara të Aneksit F nga çdo Shtet që nuk është Palë e këtij Protokolli.”

Neni 4, paragraf 2 sept

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 2 sex të nenit 4 të Protokollit:

“2 sept. Me hyrjen në fuqi të këtij paragrafi, çdo Palë duhet të ndalojë eksportimin e substancave të kontrolluara të Aneksit F, me çdo Shtet jo Palë të këtij Protokolli.”

Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të Protokollit, fjalët:

“Aneksi A, B, C dhe E”

Ndryshohen si vijon:

“Aneksi A, B, C, E dhe F”

Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 4, të Protokollit, fjalët:

“Nenet 2A deri në 2I”

Ndryshohen me:

“Nenet “2A deri në 2J”

Neni 4B

Paragrafi I mëposhtëm shtohet pas paragrafit 2 të nenit 4B të Protokollit:

“2 *bis*. Çdo Palë duhet, që duke filluar nga data 1 janar 2019 ose brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij paragrafi nëse është e mëvonshme, duhet të krijojë dhe zbatojë një sistem licencimi për importin dhe eksportin e substancave të kontrolluara të Aneksit F, pavarësisht nëse janë të reja, të përdorura, të ricikluara dhe të rigjeneruara. Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të nenit 5 dhe që çmon se nuk është në gjendje të vendosë dhe zbatojë këtë sistem nga data 1 janar 2019, mund të vonojë ndërmarrjen e këtyre veprimeve deri më 1 janar 2021”

Neni 5

Në paragrafin 4 të nenit 5 të Protokollit, fjalët:

“2I”

Ndryshohen me:

“2J”

Në paragrafët 5 dhe 6 të nenit 5 të Protokollit, fjalët:

“Neni 2I”

Ndryshohen me:

“Neni 2I dhe 2J”

Në paragrafin 5 të nenit 5 të Protokollit, përpara fjalëve:

“çdo masë kontrolluese”

shtohet:

“me”

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 8 *ter* të nenit 5 të Protokollit:

“8 *qua*

- (a) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, në bazë të ndonjë rregullimi mbi masat e kontrollit në nenin 2J në përputhje me paragrafin 9 të nenit 2, ka të drejtë të vonojë pajtueshmërinë me masat e kontrollit të paracaktuara në nënparagrafët nga (a) në (e) të paragrafit 1 të nenit 2J dhe nënparagrafëve nga (a) në (e) të paragrafit 3 të nenit 2J dhe të ndryshojë këto masa si më poshtë vijon:
- 2024 deri në 2028: 100 përqind
 - 2029 deri në 2034: 90 përqind
 - 2035 deri në 2039: 70 përqind
 - 2040 deri në 2044: 50 përqind
 - 2045 dhe në vazhdim: 20 përqind
- (b) Pavarësisht nënparagrafit (a) të mësipërm, Palët mund të vendosin se një Palë e cila vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, në bazë të ndonjë rregullimi mbi masat e kontrollit në nenin 2J, në përputhje me paragrafin 9 të nenit 2, ka të drejtë të vonojë pajtueshmërinë e tij me masat e kontrollit të parapercaktuara nga nënparagrafët nga (a) në (e) të paragrafit 1 të nenit 2J dhe nënparagrafëve nga (a) në (e) të paragrafit 3 të nenit 2J, dhe të ndryshojë këto masa si më poshtë vijon:
- 2028 deri në 2031: 100 përqind
 - 2032 deri në 2036: 90 përqind
 - 2037 deri në 2041: 80 përqind
 - 2042 deri në 2046: 70 përqind
 - 2047 dhe në vazhdim: 15 përqind
- c) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të llogaritjes së konsumit bazë sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të Aneksit F, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, plus gjashtëdhjetë e pesë përqind të konsumit të tij bazë të substancave të kontrolluara të Aneksit C, Grupi I të percaktuara në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.
- d) Pavarësisht nënparagrafit (c) të mësipërm, Palët mund të vendosin që një Palë e cila vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të llogaritjes së nivelit bazë të konsumit sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të Aneksit F, për vitet 2024, 2025, 2025, plus gjashtëdhjetë e pesë përqind të konsumit të tij bazë për substancat e kontrolluara të Aneksit C, Grupit I, siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.
- e) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe që prodhon substancat e kontrolluara të Aneksit F, për qëllime llogaritjes së nivelit bazë të prodhimit sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së llogaritura të prodhimit të substancave të kontrolluara të Aneksit F, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, plus

- gjashtëdhjetë e pesë përqind të prodhimit bazë të Aneksit C, Grupit I të substancave të kontrolluara siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.
- f) Pavarësisht nënparagrafit (e) të mësipërm, Palët mund të vendosin që një Palë e cila vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe që prodhon substancat e kontrolluara të Aneksit F, për qëllime llogaritëse të prodhimit bazë sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së llogaritur të prodhimit të substancave të kontrolluara të Aneksit F për vitet 2024, 2025 dhe 2026, plus gjashtëdhjetë e pesë përqind të prodhimit bazë të substancave të kontrolluara të Aneksit C, Grupit I, siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.
- g) Nënparagrafët nga (a) në (f) të këtij paragrafi do të zbatohen për nivelet e llogaritura të prodhimit dhe konsumit, përveç rasteve kur zbatohet një përjashtim i vendosur nga palët në lidhje me temperatura të larta ambientale”.

Neni 6

Neni 6 i Protokollit, fjalët:

“Nenet 2A deri 2I”

ndryshon:

“Nenet 2A deri 2J”

Neni 7, paragrafët 2, 3, dhe 3 ter

Rreshti vijues shtohet pas rreshtit me tekstin “- Në Aneksin E, për vitin 1991,” në paragrafin 2 të nenit 7 të Protokollit:

“- në Aneksin F, për vitet nga 2011 në 2013, përjashtimisht Palët që veprojnë sipas paragrafit 1 të nenit 5 duhet të sigurojnë këto të dhëna për vitet nga 2020 në 2022, por palët që veprojnë sipas paragrafit 1 të nenit 5, për të cilin zbatohen nënparagrafët (d) dhe (f) të paragrafit 8 *qua* të nenit 5, duhet të sigurojnë të dhëna për vitet nga viti 2024 në 2026;”

Në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të Protokollit, fjalët:

“C dhe E”

Ndryshohen:

“C, E dhe F”

Paragrafi i mëposhtëm shtohet në nenin 7 të Protokollit, pas paragrafit 3 *bis*:

“3 *ter*. Çdo Palë duhet ti dërgojë Sekretariatit të dhëna statistikore për emetimet vjetore të substancave të kontrolluara për çdo objekt sipas Aneksit F, Grupit II, në përputhje me paragrafët 1(d) të nenit 3 të Protokollit.”

Neni 7, paragrafi 4

Ne paragrafin 4 të nenit 7, pas fjalëve:

“të dhëna statistikore mbi” dhe “siguron të dhëna të”

Shtohet:

“prodhim”

Neni 10, paragrafi 1

Në paragrafin 1 të nenit 10 të Protokollit, fjalët:

“dhe neni 2I”

Ndryshohet:

“, Neni 2I dhe neni 2J”

Përmbajtja e mëposhtme shtohet në fund të paragrafit 1 të nenit 10 të Protokollit:

“Kur një Palë që vepron sipas paragrafit 1 të nenit 5 zgjedh të përdorë fonde nga çdo mekanizëm tjetër financiar që mund të rezultojë në përmbushjen e ndonjë pjese të kostove shtesë të rëna dakord, ajo pjesë nuk do të plotësohet nga mekanizmi financiar i parashikuar sipas nenit 10 të këtij Protokollit.”

Neni 17

Në nenin 17 të Protokollit, fjalët:

“Nenet 2 A deri në 2I”

Ndryshohen:

“Nenet 2 A deri në 2J”

Aneksi A

Tabela me përmbajtje si më poshtë propozohet të zëvendësohet me tabelat për Grupin I të Shtojcës A të Protokollit:

Grupi	Substanca	Potenciali Ozon-Hollues	Potenciali 100-Vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi I			
CFC13	(CFC-11)	1.0	4.750
CF2Cl2	(CFC-12)	1.0	10.900
C2F3Cl3	(CFC-113)	0.8	6.130
C2F4Cl2	(CFC-114)	1.0	10.000
C2F5Cl	(CFC-115)	0.6	7.370

Shtojca C dhe Shtojca F

Tabela me përmbajtjen e mëposhtme propozohet të zëvendësojë tabelën për Grupin I të Shtojcës C të Protokollit:

Grupi	Substanca	Numri i izomereve	Potenciali Ozon-Hollues	Potenciali 100-vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi 1				
CH ₂ FC ₂	(HCFC-21)**	1	0.04	151
CHF ₂ Cl	(HCFC-22)**	1	0.055	1810
CH ₂ FC ₂	(HCFC-31)	1	0.02	
C ₂ HFCl ₄	(HCFC-121)	2	0.01-0.04	
C ₂ HF ₂ Cl ₃	(HCFC-122)	3	0.02-0.08	
C ₂ HF ₃ Cl ₂	(HCFC-123)	3	0.02-0.06	77
CHCl ₂ CF ₃	(HCFC-123)**	-	0.02	
C ₂ HF ₄ Cl	(HCFC-124)	2	0.02-0.04	609
CHFClCF ₃	(HCFC-124)**	-	0.022	
C ₂ H ₂ FC ₂	(HCFC-131)	3	0.007-0.05	
C ₂ H ₂ F ₂ Cl ₂	(HCFC-132)	4	0.008-0.05	
C ₂ H ₂ F ₃ Cl	(HCFC-133)	3	0.02-0.06	
C ₂ H ₃ FC ₂	(HCFC-141)	3	0.005-0.07	
CH ₃ CFCl ₂	(HCFC-141b)**	-	0.11	725
C ₂ H ₃ F ₂ Cl	(HCFC-142)	3	0.008-0.07	
CH ₃ CF ₂ Cl	(HCFC-142b)**	-	0.065	2310
C ₂ H ₄ FC ₂	(HCFC-151)	2	0.003-0.005	
C ₃ HFCl ₆	(HCFC-221)	5	0.015-0.07	
C ₃ HF ₂ Cl ₅	(HCFC-222)	9	0.01-0.09	
C ₃ HF ₃ Cl ₄	(HCFC-223)	12	0.01-0.08	
C ₃ HF ₄ Cl ₃	(HCFC-224)	12	0.01-0.09	
C ₃ HF ₅ Cl ₂	(HCFC-225)	9	0.02-0.07	
CF ₃ CF ₂ CHCl ₂	(HCFC-225ca)**	-	0.025	122
CF ₂ ClCF ₂ CHClF	(HCFC-225cb)**	-	0.033	595
C ₃ HF ₆ Cl	(HCFC-226)	5	0.02-0.10	
C ₃ H ₂ FC ₂	(HCFC-231)	9	0.05-0.09	
C ₃ H ₂ F ₂ Cl ₄	(HCFC-232)	16	0.008-0.10	
C ₃ H ₂ F ₃ Cl ₃	(HCFC-233)	18	0.007-0.23	
C ₃ H ₂ F ₄ Cl ₂	(HCFC-234)	16	0.01-0.28	
C ₃ H ₂ F ₅ Cl	(HCFC-235)	9	0.03-0.52	
C ₃ H ₃ FC ₂	(HCFC-241)	12	0.004-0.09	
C ₃ H ₃ F ₂ Cl ₃	(HCFC-242)	18	0.005-0.13	
C ₃ H ₃ F ₃ Cl ₂	(HCFC-243)	18	0.007-0.12	
C ₃ H ₃ F ₄ Cl	(HCFC-244)	12	0.009-0.14	
C ₃ H ₄ FC ₂	(HCFC-251)	12	0.001-0.01	
C ₃ H ₄ F ₂ Cl ₂	(HCFC-252)	16	0.005-0.04	

C ₃ H ₄ F ₃ Cl	(HCFC-253)	12	0.003-0.03	
C ₃ H ₅ FCI ₂	(HCFC-261)	9	0.002-0.02	
C ₃ H ₅ F ₂ Cl	(HCFC-262)	9	0.002-0.02	
C ₃ H ₆ FCI	(HCFC-271)	5	0.001-0.03	

*Kur vlerësohet një rang Potencialesh Ozon-Holluese, vlera më e lartë propozohet të përdoret për qëllime të Protokollit. Vlerat e Potencialeve Ozon-Holluese të renditura si vlera të vetme, janë përcaktuar nga llogaritjet bazuar në matje laboratorike. Ato që janë renditur si një rang vlerash janë përcaktuar bazuar në vlera të përafërta dhe janë më pak të qarta. Vargu i vlerave lidhet me grupin izometrik. Vlera më e lartë është vlerësimi me ndikim më të lartë të izomerit Ozon-Hollues dhe vlera më e ulët është vlerësimi me ndikim më të ulët ozon -hollues.

**Identifikon substancat me vlerë me të lartë të zbatueshme të potencialeve ozon-holluese, të renditura kundrejt atyre të përdorura për qëllimet e Protokollit.

***Për substancat për të cilat nuk ka asnjë të dhënë për Potencialin e Ngrohjes Globale, zbatohet vlera 0 derisa një vlerë e Potencialit të Ngrohjes Globale të përfshihet nëpërmjet procedurave të parashikuara në paragrafin 9 (a) (ii) të nenit 2.

Shtojca me përmbajtje si më poshtë, propozohet të shtohet në Protokoll pas Shtojcës E:

"Shtojca F: Substancat e Kontrolluara

Grupi	Substanca	Potenciali 100-vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi I		
CHF ₂ CHF ₂	HFC-134	1100
CH ₂ FCF ₃	HFC-134a	1430
CH ₂ FCHF ₂	HFC-143	353
CHF ₂ CH ₂ CF ₃	HFC-245fa	1030
CF ₃ CH ₂ CF ₂ CH ₃	HFC-365mfc	794
CF ₃ CHFCF ₃	HFC-227ea	3220
CH ₂ FCF ₂ CF ₃	HFC-236cb	1340
CHF ₂ CHFCF ₃	HFC-236ea	1370
CF ₃ CH ₂ CF ₃	HFC-236fa	9810
CH ₂ FCF ₂ CHF ₂	HFC-245ca	693
CF ₃ CHFCHFCF ₂ CF ₃	HFC-43-10mee	1640
CH ₂ F ₂	HFC-32	675
CHF ₂ CF ₃	HFC-125	3500
CH ₃ CF ₃	HFC-143a	4470
CH ₃ F	HFC-41	92
CH ₂ FCH ₂ F	HFC-152	53
CH ₃ CHF ₂	HFC-152a	124
Grupi II		
CHF ₃	HFC-23	14800

Neni II: Lidhja me Amendamentin e vitit 1999

Asnjë Shtet ose organizatë me integritet ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një dokument për ratifikim, pranim, miratim ose zgjerim të këtij Amendamenti vetëm në rast se është depozituar më parë, ose njëkohësisht një dokument i tillë në Amendamentin e miratuar në Takimin e Njëmbëdhjetë të Palëve në Pekin më 3 dhjetor 1999.

Neni III: Lidhja me Kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe Protokollit përkatës të Kiotos mbi Ndryshimet Klimatike

Ky Amendament nuk synon të ketë efektin e përjashtimit të hidrofluorkarboneve nga fusha e angazhimeve në përmbajtje të neneve 4 dhe 13 të Kuadrit të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike ose të neneve 2, 5, 7 dhe 10 të Protokollit të Kiotos.

Neni IV: Hyrja në fuqi

1. Pritet, siç është përcaktuar në paragrafin 2, të mëposhtëm, që ky Amendament të hyjë në fuqi më 1 janar 2019, duke siguruar që të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi të Amendamentit të jenë depozituar nga Shtetet apo organizatat me integritet ekonomik rajonal, Palë të Protokollit të Montrealit mbi Substancat që hollojnë Shtresën e Ozonit. Në rastin e mosplotësimit të kushtit deri në datën e caktuar, Amendamenti propozohet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës kur është përmbushur.
2. Ndryshimet e bëra në nenin 4 të Protokollit, Kontrolli i tregtimit me vendet jo-Palë, të përcaktuar në nenin 1 të këtij Amendamenti propozohet të hyjë në fuqi më 1 janar 2033, duke siguruar që të paktën shtatëdhjetë instrumente ratifikimi, pranimi apo miratimi të Amendamentit, të jenë depozituar nga Shtetet apo Organizatat me integritet ekonomik rajonal, të cilat janë Palë të Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit. Në rastin e mosplotësimit të këtij kushti deri në datën e caktuar, Amendamenti propozohet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës kur është përmbushur.
3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, çdo instrument i depozituar nga organizatat me integritet ekonomik rajonal nuk do të merret parasysh si shtesë e atyre të depozituara nga Shtetet pjesë të këtyre organizatave.
4. Pas hyrjes në fuqi të Amendamentit, siç parashikohet në paragrafët 1 dhe 2, propozohet të miratohet për secilën Palë tjetër të Protokollit në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës së depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit, pranimi apo miratimit.

Neni V: Zbatimi i përkohshëm

Secila Palë, në çdo kohë përpara se të miratojë këtë Amendament, mund të deklarojë se do të zbatojë përkohësisht masat kontrolluese të përcaktuara në nenin 2J dhe detyrimet përkatëse raportuese të nenit 7, në pritje të hyrjes në fuqi të këtij Amendamenti.